



## RAPORT VJETOR

**Drejtuar:** Komitetit Drejtues në mbledhjen e datës 12 Nentor 2018  
**Periudha e Raportimit:** Janar 2018 – Dhjetor 2018  
**Përgatitur nga:** Drejtori Ekzekutiv i ShBSh



## I-Vështrim i përgjithshëm

Të nderuar anëtarë të Komitetit Drejtues,

Në këtë takim të radhës të Komitetit Drejtues (KD) po pasqyrojmë aktivitetet dhe rezultatet e punës së kryer deri tani gjatë vitit 2018 nga Shoqata. Ky vit ka qenë mjaft intensiv në funksionimin e veprimtarisë së përditshme të Shoqatës, përfshirë këtu takime të Forumeve Profesionale, pregatitjen e qëndrimeve ndaj çështjeve lidhur me pushtetin vendor, komunikimin me anëtarësinë dhe bashkëpunimin me aktorë të tjerë në realizimin e aktiviteteve të ndryshme.

Vëmendje të vecantë kan pasur reagimet dhe qëndrimet e Shoqatës ndaj ndryshime ligjore, në pushtetin vendor të cilat kanë qenë të shumta, si dhe bërja publike e këtyre qëndrimeve në media dhe tek donatorët që veprojnë në Shqipëri. ShBSh është anagazhuar fuqimisht duke bërë prezent qëndrimin e argumentuar në mbrojtje të decentralizimit dhe të bashkive për çështje mjaft të rëndësishme si sistemi i taksave vendore, metodologjia e vleresimit të taksës së ndërtesës, caktimi i një agjenti në mbledhjen e kësaj takse, përmbyllja e proceseve tranzitore të titujve të pronësisë, projektligji për teatrin, strehimi social etj.

Gjatë këtij viti, Shoqata ka nisur zbatimin e projekteve të reja nën mbështetjen e Interred Med dhe IPA Crossborder me tematika si përballimi i emergjencave civile, ofrimi i shërbimeve lokal për persona me aftësi të kufizuara dhe promovimi i bujqësisë dhe biznesit të vogël turistik.

ShBSh vazhdon të jetë përfaqësuesja e vetme e bashkive në NALAS - Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale në Europën Juglindore dhe CMRE - Këshilli Evropian i Bashkive dhe Rajoneve. Kemi shfrytëzuar mundësitë që dalin nga ky anëtarësim për t'ju bërë të ditur shqetësimet tuaja, për tu përfshirë në forume apo trajnime për stafin e bashkive tuaja.

Përveç kësaj, dhe vetë Shoqata ka vazhduar ofrimin e asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve të bashkive mundësuar pjesëmarrjen në takime, seminare dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit në bashkëpunim me aktorë të tjerë apo të organizuar nga vetë Shoqata. Gjithë veprimtaria dhe angazhimi ynë përgjatë këtij viti dhe më parë i kanë siguruar Shoqatës një pozicion të konsoliduar si partner i besueshëm në përfaqësim të bashkive.

Pjesë e këtij Raporti është dhe Plani i Aktiviteteve për 2019, por duke qenë vit zgjedhor mbetet për tu propozuar nga ju cilat aktivitete mund të kryhen dhe në cilën periudhë të vitit.



## II-Aktivitetet të realizuara

### 1. Lobimi dhe përfaqësimi mediatik

Gjatë këtij viti kemi përgatitur disa dokumente politikash dhe qëndrime ndaj nismave të ndryshme ligjvënësë të qeverisë. Këtu përmendim:

- Per buxhetin dhe ndarjen e Fondeve nga Komiteti i Zhvillimit të Rajonave,
- Për sistemin e taksave vendore;
- Për strehimin social;
- Për metodologjinë e taksës së ndërtesës dhe caktimin e një agjenti për mbledhje të saj;
- Për teatrin, etj.

Këto qëndrime janë prezantuar në qeveri sipas ministrive përkatëse, tek Presidenti i Republikës dhe tek donatorët e partnerët tanë në Strasburg dhe Bruksel. ShBSh, ka punuar fort të ndërgjegjësojë partnerët dhe donatorët për situatën e vështirë të qeverisë vendore, decentralizimin e pamjaftueshëm dhe ndarjen e padrejtë të fondeve ndaj bashkive të djathta, mos përgatitjen në kohë të bazës ligjore për funksionet e reja etj. Ka disa arritje krahasuar me dy vitet e para post reformë, por sërish ka shumë probleme.

ShBSh ka qenë mjaft prezente në median vizive dhe të shkruar përmes stafit të saj qëndror, me Kryetaren e Shoqatës dhe me cdonjërin nga ju duke ngritur gjithmonë çështje që mbrojnë interesat e cdo bashkie dhe parimet e decentralizimit. Gjatë këtij viti prezenca në media e ShBSh ka arritur në mbi 80 kronika dhe mbi 30 debate televizive, pa përfshirë këtu daljet mediatike të Kryetares apo cdo kryetari tjetër si anëtar i Komitetit Drejtues. Veprimtaria jonë ka gjetur pasqyrim dhe në shtypin e shkruar, ku thuajse të gjitha gazetat na kanë përcjellë. Ky është një kontribut shumë i mirë bërë nga secili prej jush.

- a- Çështje me interes. Bashkitë duhet të forcojnë rolin proaktiv me reagime në kohën e duhur dhe duke përcjellë informacionin mbi nevojat dhe shqetësimet lokale, nga të zgjedhurit dhe administrata.
- b- Rekomandime. Prezantimi i problematikave në kontekstin real dhe lokal, me peshë në komunitet dhe ndjeshmëri publike.
- c- Për tu bërë në vazhdimësi. Një përmbledhje e qëndrimeve të ShBSh dhe prezantimi i tyre.

### 2. Shërbimi për anëtarët

Gjatë kësaj periudhe është punuar mirë edhe me shërbimet që ka pasur mundësi të ofrojë Shoqata e Bashkive. Këtu rendisim trajnimet e punonjësve të bashkive në zyrat e shoqatës por dhe nëpër bashki. Janë realizuar trajnime mbi sistemin e taksave dhe financat vendore. Me mbështetjen e Hans Seidel Foundation dhe me specialistë të Ministrisë së Financave janë



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

kryer 17 trajnime në vendin e punës me specialistët e zyrëave të taksave dhe tarifave vendore për zbatimin e metodologjisë së re të miratuar.

Po kështu testuam në disa bashki (Mat, Klos, Lezhe dhe Skrapar) sistemim informativ të kadastrës fiskale. Realizuar trajnimin mbi lëvizshmërinë e qëndrueshme urbane, me mbështetjen e ORF-GIS me pjesëmarrjen e 25 bashkive.

Trajnime për stafet e bashkive mbi menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë janë ofruar brenda dhe jashtë vendit, ku përfitues kanë qenë disa bashki. Për tu përmenduar këtë vit, janë dhe vizitat zyrtare të kryetarëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë marsit 2018, si dhe disa trajnime në Turqi, Slloveni, Maqedoni, Itali, Greqi, Gjermani me mbështetjen e partnerëve të SHBSH etj si dhe Vizita në bashkite e Malit të Zi dhe Gjermani mbështetur nga fondacioni KAS. Këto vizita kanë sjellë një impuls të ri në vizionin për qeverisjen e mirë.

### 3. Komunikimi me anëtarësinë dhe aktorë të tjerë

Komunikimi ka qenë tepër i mirë dhe efikas me të gjitha mjetet. Shoqata e Bashkive pasqyron aktivitetet, zhvillimet më të rëndësishme në fushën e qeverisjes vendore, si publikon njoftimet dhe aktivitetet në media sociale si Facebook, dhe në faqen e saj të internetit [ëëë.aam.org.al](http://ëëë.aam.org.al). Gjithashtu, dërgojmë paketa të materialeve të nevojshme për t'ju shpërndarë bashkive mbi legjislacionin vendor dhe të tjera.

Shoqata ka nisur pregatitjen e buletinit elektronik i cili pasqyron veprimtarinë e Shoqatës dhe të reja me interes për bashkitë. Ky buletin shpërndahet në 3000 adresa emaili.

Gjithashtu ne publikojmë lajme nga qeverisja vendore në Shqipëri, dy herë në muaj në gazetën e NALAS, që shpërndahet në mënyrë masive tek të gjithë programet, projektet dhe institucionet rajonale dhe në Evropë. Komunikimi me komunitetin e donatorëve brenda dhe jashtë vendit është në nivele të kënaqshme, ne ndajmë me ta të gjitha deklaratat, qëndrimet dhe opinionet mbi zhvillimin e pushtetit vendor, mbi padrejtësitë që anojnë nga bashkitë e djathta etj.

Komunikimi dhe bashkepunimi me organizatat partnere dhe anëtare janë efektive, edhe pse duhet të kishte më shumë produktivitet, por arsye është fakti që ka një penalizim ngaqë shoqatat janë të ndara politikisht. Kjo frymë është më tepër tek partneret dhe donatorët në Shqipëri, ndërsa jashtë vendit jemi të mirë pozicionuar, por dhe këtu ky vit ka shënuar progres, edhe në bashkëpunimin me Shoqatën për Autonomi Vendore.

Marrëdhënie shumë të mira kemi me NALAS (Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Vendore në Europën Juglindore), i cili është një mbështetës dinjitoz për ne edhe pse në këto kushte.

Jemi anëtarë në 5 task forca ku marrim pjesë dhe përfaqësohen thujse të gjitha bashkitë tuaja.



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Me CMRE (Këshilli i Qyteteve dhe Rajoneve Europiane) kemi bashkëpunim të mirë dhe aktivitete të pakta. Së fundmi, CEMR ka kërkuar qëndrimin tonë lidhur me kërkesën e SHAV për anëtarësim.

Me ALDA (Shoqata e Agjensive të Demokracisë Vendore), kemi bashkëpunim të mirë dhe aktivitete të pakta. Aktualisht po zhvillojmë aktivitete për qeverisjen e hapur me dy bashki partnere: Kamëz dhe Vau Dejës.

Nuk kemi përfaqësimin që duam (dhe kjo për arsye politike) në Kongresin e Autoriteteve Lokale të Këshillit të Europës, por ne i përcjellim rregullisht shqetësimet tona.

Shoqata ka përfaqësuesit e saj në çdo bord dhe agjensi apo komitete të përkohshme të projekteve si STAR 2, Strategjinë e ujit, Projektin Reload, Projektin Protax, dhe në Këshillin Konsultativ. Në këto pozicione përfaqësuesit në cdo rast mbrojnë interesat e bashkive.

### **4. Forumet profesionale.**

Sipas statutit, ShBSh ka 6 forume profesionale Forumi i Ekonomisë dhe Zhvillimit Vendor; Forumi i Infrastrukturës dhe Urbanistikës, Forumi i Cështjeve Sociale dhe Edukimit, Forumi i Cështjeve Ligjore, Administrative dhe Prokurimit Publik, Forumi i Shërbimeve Publike dhe Forumi i Bujqësisë dhe agroturizmit.

Këto forume janë mbledhur rregullisht dy herë në vit. Gjashtë takimet e para të forumeve janë organizuar gjatë mars-prill 2018, ndërsa 6 të dytat sapo kanë përfunduar. Tematika e tyre ka qenë aktuale si për shembull taksa e ndërtesës, skema e granteve në bujqësi, sistemi i ndihmës ekonomike etj. Por duhet theksuar se këto forume kanë kontribuar në dhënien e mendimeve për projektligje të ndryshme për të cilat qeveria ka kërkuar mendimin e ShBSh.

Këtu permendim kontributin e forumeve për diskutimin e metodologjisë së taksës së ndërtesës, për caktimin e agjentit për mbledhjen e kësaj takse nga OShEE, për proceset tranzitore të regjistrimit të pronave dhe tokave bujqësore, për ndihmën ekonomike dhe strehimin social, etj. Këto forume ndër të tjera kanë ndihmuar edhe në zhvillimin e kapaciteteve të stafeve dhe në shkëmbimin e ekpëriencave mes bashkive dhe praktikave përkatëse.

- a- Cështje me interes: Dhe pse kemi një numër të vogël anëtarësh, puna e profesionistëve nga bashkitë sipas fushave duhet të institucionalizohet me shumë nga ShBSh. Këto forume duhet të përcjellin njohuritë e tyre për zbatim në bashki.
- b- Rekomandime: Kërkohet më shumë interes dhe mbështetje nga ju sa i përket pjesëmarrjes së stafeve në forume dhe më shumë angazhim prej tyre. Gjithashtu duhet të rrisim frekuencën e takimeve të KD, duke ruajtur rotacionin e mbledhjes.
- c- Hapa në vazhdim: Për vitin e ardhshëm do përpiqemi të rrisim frekuencën e forumeve dhe tju japim më shumë vizibilitet tematik.

### **5. Projektet e asistencës dhe bashkëpunimit**



## Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Shoqata është në fazat e para të zbatimit të disa projekteve nga programet e Bashkimit Evropian si:

*Lidershipi i 61 bashkive* (STAR 2 në bashkëpunim me ShAV dhe Partners Albania), *Local4Green* (politika fiskale mjedisore) nga Interreg Med, ku partnerë janë Lezha, Kukësi dhe Vau Dejës;

*Flat nga Intereg IPA CBC IT-AL*, për menaxhimin e rreziqeve nga rrëshqitjet dhe përmytjet ku partnerë do jone bashkitë Lezhë, Vau Dejë dhe Shkodër, si dhe bashki të tjera që kanë interes të trajtojnë stafet e tyre në shkollën që do ngrihet për këtë qëllim në Mal të Zi;

*Med Net* (dieta mesdhetare) nga Intereg MED, projekt që mbështet bujqësinë dhe blegtorinë;

*4Plus*-program që do ndihmojë në krijimin e një platforme për identifikimin e grupeve me aftësi ndryshe nga Intereg IPA CBC-GR-AL;

*Projekti RCDN*, zhvillimi i kapaciteteve në sektorin e ujit në bashkëpunim me NALAS/ORF-GIZ.

- a- Cështje me interes: ShBSh ndeshet me vështirësi të likuiditeve, edhe pse jemi në fillimet e tyre.
- b- Rekomandime: duhet të jemi më selektiv dhe të refuzojmë mbase kërkesa për partneritet në disa raste.
- c- Hapa në vazhdim: Duhet të rishikohet kontributi i bashkive lidhur me kuotën, për të siguruar vetqendrueshmëri financiare, pavarësi dhe kapacitete likuiduese.

### 6. Publikimet dhe media sociale

ShBSh ka eksperiencë të mira në këtë drejtim. Por referuar rrethave që dihen nuk kemi qenë shumë ndihmues për bashkitë, pasi ende nuk janë përgatitur publikime që ju shërbejnë administratave të bashkive. Edhe pse në vështirësi burimesh dhe financash, falë mbështetjes së Hans Seidel do sjellim së shpejti Udhëzuesin për Zhvillimin e Programit të Menaxhimit të Emergjencave Bashkiake.

Këtë vit kemi nxjerrë dy botime të gazetës elektronike që ndahet në mbi 3000 adresa. Kjo gazeta publikohet në shqip dhe anglisht. Aktivitetet, mendimet, qëndrimet e shoqatës prezantohen, dokumentohen, pasqyrohen shumë mirë në faqen e internetit [www.aam.org.al](http://www.aam.org.al), në Facebook <https://www.facebook.com/shoqatabashkiveteshqiperise>, në titter <https://twitter.com/aamlogov>.

- a- Cështje me interes: Prezantimi dhe mediatizimi i arritjeve duhet të përdoret për të qenë sa më transparent dhe në funksion të qeverisjes së hapur.
- b- Rekomandime: Kërkohe më shumë bashkëpunim nga bashkitë për të na furnizuar me praktikën e tyre me interes për publikim.
- c- Hapa në vazhdim: Duhet të ndërtojmë një sistem më interaktiv të komunikimit me bashkitë por jo vetëm.

### 7. Burimet financiare dhe shpenzimet-

Raporti financiar për të ardhurat dhe shpenzimet e vitit 2018 është bashkangjitur raportit narrativ.



**8. Aktivitete për vitin 2019**

Plani i aktiviteteve për vitin 2019, Çështje për tu adresuar; për diskutim dhe miratim nga Komiteti Drejtues.

*Faleminderit!*

Agron Haxhimali  
Drejtor Ekzekutiv